



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

**Datë: 28.02.2022**

Në bazë të nenit 13, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenit 8, të Rregullores së Ministrisë së Financave dhe Transfereve, MF-Nr.04/2017, të datës 13.06.2017, mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të Organizatave Jo Qeveritare, nenin 44, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, bënë këtë :

**THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM**

Njoftohen përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile se mund ti dërgojnë propozimet e tyre për plotësimin e Komisionit vlerësues i cili do të formohet me qëllim të vlerësimit të aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve, të OJQ-ve që veprojnë në Komunën e Fushë Kosovës për projektet që kontribuojnë në avancimin dhe afirmimin e kulturës rinisë dhe sportit të cilët kanë aplikuar sipas thirrjes publike për aplikim të datës : 18.02.2022

Ky Komision do të formohet me qëllim të vlerësimit të aplikacioneve për financimin e projekt/programeve të OJQ-ve për avancimin dhe afirmimin e kulturës rinisë dhe sportit në Komunën e Fushë Kosovës, ku do të plotësohet me:

- Një përfaqësues nga Organizatat Jo Qeveritare
- Një përfaqësues nga shoqëria civile në cilësinë e ekspertit

Propozimet tuaja do të jenë të mirëpritura dhe duhet t'i drejtohen Drejtorisë për Kulturë, Rinë dhe Sport dhe të njejtat të dorëzohen në ndërtesën e Komunës së Fushë Kosovës ( zyra pritëse) për shërbim me qytetarë më së largu deri më datë: 03.03.2022.

Nr: 01/2022  
Fushë Kosovë

